



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 4675/prot.

Himarë, më 11.10.2023

PROJEKTVENDIM

Nr. 39 datë, 11.10.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT MAKSIMAL TË PUNONJËSVE
TË POLICISË BASHKIAKE**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake” ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e numrit maksimal të punonjësve të policisë bashkiake për Bashkinë Himarë, i cili do të jetë 25 punonjës në total.
2. Ky ndryshim do të bëhet në strukturën për vitin 2024, pas miratimit të buxhetit të bashkisë për vitin 2024.
3. Ngarkohet drejtoria e burimeve njerëzore dhe shërbimeve mbështetëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro



DREJTORIA JURIDIKE

Klejli Muharremi

DREJTOR I DBNJSHM

Andon Xani



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 4675/prot.
2

Himarë, më 11 .10 .2023

RELACION SQARUES

Lënda: Për përcaktimin e numrit maksimal të punonjësve të policisë bashkiake

KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË

Në zbatim të pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”, ku citohet se: “Këshilli Bashkiak miraton buxhetin dhe numrin maksimal të punonjësve të Policisë Bashkiake” po ju paraqesim këtë projektvendim për miratimin e numrit maksimal të punonjësve të Policisë Bashkiake. Aktualisht në strukturën e Policisë Bashkiake janë 14 punonjës, ky numër nuk mjafton për të kontrolluar territorin e madh të bashkisë tonë dhe sidomos gjatë sezonit turistik që popullsia shtohet disa herë më shumë se popullsia aktuale gjithashtu shtohet edhe ngarkesa e policisë bashkiake për monitorimin e hapësirave të plazheve. Gjithashtu gjatë sezonit turistik puna e policisë bashkiake do të organizohet me tre turne dhe për këtë duhet patjetër të rritet numri i punonjësve. Për këto arsye dhe mbarëvajtjen e punës të kësaj strukture propozojmë që numri total i punonjësve në strukturën e Policisë Bashkiake të bëhet minimalisht 25.

Për sa ju parashtruar në këtë relacion, bazuar në kërkesat pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”, kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi nga ana e Këshillit Bashkiak.

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro



DREJTORIA JURIDIKE

Klejli Muharremi

DREJTOR I DBNJSHM

Andon Xani